

UDHËZIM
Nr.32, datë 26.10.2009

**PËR REGJISTRIMIN DHE VLERËSIMIN E NXËNËSVE QË KANË PËRFITUAR AZIL
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, regjistrohen në arsimin parashkollor mbi bazën e certifikatës së lindjes. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojnë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.

2. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, por nuk zotërojnë certifikatën e lindjes, të regjistrohen në arsimin parashkollor sipas dëshmisë së prindërve dhe dokumentacionit që ai zotëron në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojnë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.

3. Nxënësi që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, për të vazhduar studimet në arsimin bazë ose të mesëm, të regjistrohet në bazë të dokumentit shkollor të shtetit nga vjen, të përkthyer e noterizuar dhe të sigluar në DAR/ZA sipas vendbanimit ku ai është vendosur. Nxënësi regjistrohet në:

- a) klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;
- b) klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor.

4. Nxënësi i shkollës 9-vjeçare, që nuk provon me dokument shkollor të shtetit nga vjen vazhdimin apo përfundimin e një klase, provohet për shkallën e njohurive nga një komision i posaçëm që ngrihet në DAR/ZA. Komisioni harton procesverbalin përkatës të firmosur nga të gjithë anëtarët e tij. Mbi bazën e këtij procesverbali që depozitohet në DAR/ZA, drejtori i DAR/ZA lëshon vërtetimin për regjistrimin e nxënësit në klasën që miraton ky komision. Shkolla në të cilën regjistrohet nxënësi, mban në amzën e vet vërtetimin e mësipërm.

5. Nxënësi i cili ka kryer 8 vite shkollore, regjistrohet në klasën e 9-të me ose pa shkëputje nga puna sipas moshës që ka.

6. Për regjistrimin e tij, nxënësi paraqet pranë DAR/ZA dëftesë (dëftesat) origjinale të përkthyer dhe noterizuara. DAR/ZA bën konvertimin dhe ekuivalentimin e notave dhe siglon dëftesën e nxënësit. Drejtori i DAR/ZA përcakton shkollën ku do të vazhdojë studimet nxënësi që plotëson kushtet e mësipërme.

7. I huaji azilant, i cili provon me dokumente përfundimin e shkollës së mesme, ka të drejtë të konkurrojë për t’u regjistruar në institucionet e arsimit të lartë publik (IAL), sipas udhëzimeve përkatëse që harton MASH, për kriteret e ekuivalentimit dhe regjistrimit në IAL.

8. Shtetasit që nuk zotërojnë dokumentet e përfundimit të arsimit të mesëm, nuk mund të përfitojnë nga e drejta e arsimimit në IAL.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare dhe Drejtoria e Kurrikulës dhe Monitorim Vlerësimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

